



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I EDUKIMIT

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 229 201 • E-mail: edukimi@uni-pr.edu • edukimi.uni-pr.edu

Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakulteti i Edukimit

Programi i studimit:

MA Master i Shkencave të Edukimit (me specializim)

Specializimet:

Këshillim Pedagogjik

Edukim Inkluziv

Udhëheqje në Arsim

Mësimdhënia dhe Kurrikula

Niveli i studimeve:

Master

Numri i kredive:

120 ECTS

Akredituar për periudhën:

1 Tetor 2024 - 30 Shtator 2027

1. QËLLIMI DHE PROFILI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Qëllimi kryesor i programit MA SHKENCA TË EDUKIMIT është të pajisë studentët me aftësitë dhe njohuritë përkatëse për të qenë në gjendje të punojnë në mjedise të ndryshme të edukimit. Programi bazohet në konceptin e 'mësimdhënies së bazuar në dëshmi dhe mësimdhënies së bazuar në praktikë dhe mbron këtë qasje përmes përmbajtjes së programit dhe formës së zbatimit të tij. Për më tepër, programi është hartuar me nevojën për të kombinuar qasjen teorike dhe trajnimin praktik për të ushtruar profesionin. Në këtë kuptim, përveç kurseve të caktuara teorike, programi gjithashtu përfshin pjesën praktike në një institucion arsimor përkatës, si dhe një seminar kërkimor që synon ofrimin e mundësive për studentët për të zhvilluar aftësitë e tyre kërkimore duke i lidhur ato me praktikën e tyre në një institucion dhe realizimin e tezës master. Programi synon t'u sigurojë studentëve shkathtësitë e duhura për ballafaqimin me sfidat e sistemit shkollor të Kosovës. Brenda këtij programi, studentët do të kenë mundësinë të specializohen në fusha të caktuara. Programi është i organizuar në një mënyrë të tillë që në vitin e parë të studimit është i përbashkët për të gjitha specializimet (me mundësinë e zgjedhjes së disa kurseve që korrespondojnë me specializimin përkatës) duke siguruar një strukturë më koherente të arsimimit të profesionistëve në fushën e arsimit. Për më tepër, pjesa e përbashkët i programit do të organizohet në atë mënyrë që të adresohen specifikat e secilit specializim.

Misioni i programit MA në Shkenca të Edukimit është në përputhje me misionin e Fakultetit të Edukimit. Misioni i programit është të ofrojë një program cilësor për përgatitjen dhe trajnimin e vazhdueshëm të specialistëve në fushën e arsimit me qëllim rritjen e aftësive.

2. REZULTATET E PRITURA TË PROGRAMIT

Në fund të studimeve, të diplomuarit do të jenë në gjendje të:

- Zhvillojnë njohuri dhe shkathtësi për të analizuar në mënyrë kritike fenomenet arsimore në një kontekst kombëtar dhe ndërkombëtar duke integruar aspekte shkencore dhe praktike në fushën e arsimit në përgjithësi dhe në fushën e specializimit në veçanti;
- Analizojnë në mënyrë kritike dokumentet e politikave arsimore, literaturën adekuate në lidhje me profesionin dhe rolin përkatës të studentëve në systemin arsimor;
- Realizojnë kërkime praktike në fushën e arsimit në përgjithësi dhe në fushën e ngushtë specializimit përmes zbatimit të një metodologjie bashkëkohore hulumtuese;
- Zbatojnë njohuritë e tyre teorike dhe praktike për të ushtruar rolin e tyre në sistemin arsimor në një mjedis që promovon vlera gjithëpërfshirëse;
- Shfaqin vlera ndërkulturore, promovojnë të drejtat e njeriut, barazinë, tregojnë gatishmëri për komunikim dhe punë ekipore në mjedise gjithëpërfshirëse arsimore dhe më gjerë
- Demonstruojnë shkathtësi për planifikim, vlerësim efektiv dhe promovim të praktikave të mira të filozofisë me nxënësin në qendër duke përdorur teknologjinë e avansuar në arsim;
- Demonstruojnë shkathtësi të larta të udhëheqjes dhe menaxhimit efektiv të institucioneve arsimore dhe shkathtësi të larta të këshillimit pedagogjik;
- Vlerësojnë dhe dokumentojnë zhvillimin e tyre profesional si punonjës të sistemit arsimor dhe avancojnë rolin e tyre në zhvillimin e sistemit shkollor dhe profesionit të mësimdhënësit;
- Kontribuojnë në zhvillimin e kurrikulave dhe në planifikimin e punës mësimore bazuar në teori dhe praktika bashkëkohore të arsimit.

3. PROGRAMI STUDIMOR: Master i Shkencave të Edukimit (me specializim)

VITI I					
SEMESTRI I			ORË/JAVË		ECTS
Nr.	O/Z				
1	O	Mësimdhënia efektive dhe kurrikula	3	1	6
2	O	Metodat e hulumtimit kuantitativ	2	2	5
3	O	Politikat arsimore dhe legjislacioni	3	0	5
4	O	Teknologjitë e edukimit dhe mësimi elektronik	2	2	5
5	O	Komunikimi në arsim	2	1	5
6	Z	Shkrim akademik	2	0	4
7	Z	Vendimmarrja e bazuar në dëshmi	2	0	4
8	Z	Inovacioni në Arsim	2	0	4
9	Z	Etika dhe Integriteti Akademik	2	0	4
SEMESTRI II					
1	O	Metodat e hulumtimit kualitativ	2	2	6
2	O	Praktika bashkëkohore në edukimin inkluziv	3	1	6
3	O	Psikologji e zbatuar në mësimdhënie	3	0	5
4	O	Vlerësimi në arsim	2	2	5
5	Z	Histori e arsimit kombëtar	2	0	4
6	Z	Arsimi ndërkombëtar dhe krahasues	2	0	4
7	Z	Statistikë dhe SPSS	2	0	4
8	Z	Mësimdhënia në arsimin e lartë	2	0	4
9	Z	Mësimdhënësi hulumtues	2	0	4

Specializimi: KËSHILLIMI PEDAGOGJIK

SEMESTRI III					ECTS
1	O	Teoritë e këshillimit	2	2	6
2	O	Sigurimi i cilësisë në arsim	2	2	6
3	O	Zhvillimi profesional i mësimdhënësve	2	1	5
4	O	Menaxhimi i projekteve	3	0	5
5	Z	Vështirësitë në të nxënë	2	0	4
6	Z	Praktikum i punës së pedagogut	2	0	4
7	Z	Zhvillimi i kurrikulave	2	0	4
8	Z	Edukimi në fëmijërinë e hershme	2	0	4
SEMESTRI IV					
1	O	Praktika Pedagogjike	3	0	5
2	O	Seminar hulumtimi	3	0	5
3	O	Teza e masterit			20

Specializimi: EDUKIMI INKLUZIV

SEMESTRI III					ECTS
1	O	Zhvillimi atipik	2	2	6
2	O	Vështirësitë në të nxënë	2	2	6
3	O	Vështirësitë në të folur	2	2	6
4	O	Laboratori pedagogjik	0	3	4
5	Z	Menaxhimi i klasës inkluzive	2	0	4
6	Z	Mësimdhënia e diferencuar dhe Plani individual i edukimit (PIE)	2	0	4
7	Z	Sistemet mbështetëse të edukimit inkluziv	2	0	4
8	Z	Identifikimi dhe intervenimi i hershëm	2	0	4
9	Z	Diversiteti dhe drejtësia sociale	2	0	4
SEMESTRI IV					
1	O	Praktika Pedagogjike	3	0	5
2	O	Seminar hulumtimi	3	0	5
3	O	Teza e masterit			20

Specializimi: UDHËHEQJA NË ARSIM

SEMESTRI III					ECTS
1	O	Ndryshimet në arsim	3	1	6
2	O	Menaxhimi i institucioneve arsimore	2	2	6
3	O	Teoritë dhe stilet e menaxhimit	3	0	5
4	O	Planifikimi në arsim	2	2	5
5	Z	Menaxhimi i projekteve	2	0	4
6	Z	Kultura organizative	2	0	4
7	Z	Sigurimi i cilësisë në arsim	2	0	4
8	Z	Zhvillimi profesional i mësimdhënësve	2	0	4
SEMESTRI IV					
1	O	Praktika Pedagogjike	3	0	5
2	O	Seminar hulumtimi	3	0	5
3	O	Teza e masterit			20

Specializimi: MËSIMDHËNIA DHE KURRIKULA

SEMESTRI III					ECTS
1	O	Teoritë kurrikulare	2	2	6
2	O	Modele të mësimdhënies ndërvepruese	2	2	6
3	O	Konteksti social dhe kulturor i mësimdhënies	2	1	5
4	O	Inteligjenca artificiale në edukim	2	1	5
5	Z	Edukimi në fëmijërinë e hershme	2	0	4
6	Z	Diversiteti në arsim	2	0	4
7	Z	Planifikimi në arsim	2	0	4
8	Z	Kurs i avancuar në menaxhimin e klasës	2	0	4
SEMESTRI IV					
1	O	Praktika Pedagogjike	3	0	5
2	O	Seminar hulumtimi	3	0	5
3	O	Teza e masterit	2	0	20

4. PËRSHKRIMET E KURSEVE

Përshkrimi për kurset e përgjithshme

MËSIMDHËNIA EFEKTIVE DHE KURRIKULA

Kursi ofrohet për të promovuar bazën historike, filozofike e pedagogjike të procesit të nxënit dhe të mësimdhënies. Përmes këtij kursi ofrohen njohuri e shkathtësi themelore përkitazi me kompleksitetin e procesit të të nxënit, bazën filozofike, e sociale të të nxënit, teoritë e të nxënit: teoria bibehavioriste, kognitivist, sociale, konstruktivist, holistike, humaniste, teoria e procesimit të informacionit etj, stilet e të nxënit: autitiv, vizuel, kinestetik, global, kronologjik, intuitiv, reflektiv etj. Studentët do të kenë mundësinë të analizojnë teoritë dhe qasjet kryesore kurrikulare dhe efektet e tyre në procesin e të nxënit dhe mësimdhënies së suksesshme dhe të promovojnë zhvillimin e të menduarit kritik dhe kreativ.

METODAT E HULUMTIMIT KUANTITATIV

Ky kurs fokusohet në zhvillimin e njohurive dhe shkathtësive të studentëve për të planifikuar dhe realizuar hulumtime sipas qasjes kuantitative. Duke siguruar një ndërlidhje në mes të teorisë dhe praktikës, ky kurs i pajis studentët me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për zhvillim të hulumtimeve rigoroze kuantitative, për të analizuar të dhënat dhe për të nxjerrë përfundime domethënëse. Ky kurs mbulon tematikat kryesore rreth metodave të hulumtimit kuantitativ, duke përfshirë konceptualizimin e hulumtimit kuantitativ, ontologjinë dhe epistemologjinë e hulumtimeve kuantitative, modelet e hulumtimit, dizajni i hulumtimit, teknikat e kampionimit, instrumentet e mbledhjes së të dhënave, analiza e të dhënave dhe interpretimi i të dhënave përmes programit SPSS. Përgjatë semestrit, studentët do të fitojnë përvojë praktike në formulimin e pyetjeve kërkimore, hartimin e hulumtimeve kuantitative, kryerjen e analizave statistikore dhe komunikimin efektiv të gjetjeve. Deri në fund të kursit, studentët do të jenë të përgatitur për të hartuar dhe kryer hulumtime përmes qasjes kuantitative dhe për të vlerësuar në mënyrë kritike hulumtimet ekzistuese.

POLITIKAT ARSIMORE DHE LEGJISLACIONI

Kursi ka për qëllim të ndihmojë studentët të kuptojnë qartë konceptin e politikës arsimore, hartimin dhe zbatimin e tyre në praktikë. Në veçanti kursi do të shtjellojë kontekstin e politikave arsimore në nivel local, Evropian dhe global duke synuar një analizë kritike të tyre në lidhje me traditat e ndryshme të funksionimit të sistemeve arsimore duke analizuar ato krahas trendeve globale të reformës arsimore nën frymën neoliberales. Përveç kësaj, kursi do të vë në dukje për studentët ciklin e politikave, duke përfshirë një orientim praktik për hartimin e politikave, monitorimin dhe vlerësimin e tyre. Në këtë kontekst do të shtjellohen dimensione praktike të përceptimit të politikave në nivel Kosove dhe do të shtjellohet procesi praktik i hartimit të legjislacionit primar dhe sekondar.

TEKNOLOGJITË E EDUKIMIT DHE MËSIMI ELEKTRONIK

Kursi synon që të zhvillojë në mënyrë teorike dhe praktike njohuritë lidhur me konceptet dhe llojet kryesore të Teknologjive të Edukimit dhe atyre të Internetit për mbështetje të mësimdhënies dhe procesit të të nxënit, inkluzionit dhe menaxhimit të procesit mësimor. Kursi shtjellon konceptet multimediale dhe interaktive në mjedise të reja të mësimdhënies dhe të të nxënit. Kursi fokusohet në aftësimin teorik dhe praktik të studentëve për të shfrytëzuar teknologjitë për mësimdhënie dhe

të nxënë aktiv, TIK-un si medium dhe vegël mbështetëse për praktikat inkluzive, platformat për mësimdhënie, simulatorët e ndryshëm për realizimin e eksperimenteve dhe animacioneve kompjuterike në edukim, teknologjitë e bashkëpunimit të mbështetura nga kompjuteri, teknologjitë për vlerësim, teknologjitë e të nxënësve elektronik në kontekst, si dhe teknologjitë për menaxhim elektronik. Studentët mësojnë se si t'i vlerësojnë Teknologjitë e Edukimit dhe ato të Internetit për nga aspekti i ngritjes së performancës së mësimdhënies dhe të nxënësve, inkluzionit dhe mundësisë për menaxhim elektronik për të mbështetur të menduarit kritik, kreativitetin, inovacionin, monitorimin dhe aktivitetet mësimore në një perspektivë gjithëpërfshirëse.

SHKRIM AKADEMIK

Ky kurs është planifikuar me qëllim që t'u mundësojë studentëve studimin e teknikave dhe të mënyrave të shkrimit akademik. Në këtë kurs do të trajtohen në detaje procesi i të shkruarit (nga qëllimi dhe lexuesi e deri te kopja përfundimtare), dizajni i të shkruarit, zhvillimi i hapave që duhet ndjekur gjatë të shkruarit, ndarjen teorike të esesë dhe shkrimin e esesë. Po ashtu lënda jep edhe mundësi për debat rreth problemeve bazike gjuhësore, gjithmonë në shërbim të të shkruarit sa më të drejtë e sa më shkencor

VENDIMMARRJE BAZUAR NË DËSHMI

Qëllimi i kursit është që studentët të kuptojnë përmirësimin e cilësisë së vendimmarrjes në shkollë përmes përdorimit të dëshmive nga burime të shumta si: të dhënat të shkollës, analizat e ndryshme të sistemit të arsimit që janë në dispozicion si dhe karakteristikat sociale dhe ekonomike të nxënësve të shkollës dhe komunitetit, dhe vlerësimet e ndryshme kombtare dhe ndërkombtare. Pra, ky kurs merr një qasje të bazuar në problematika dhe raste reale të bazuara në kontekstin shkollë.

INOACIONET NË ARSIM

Kursi synon t'ju ndërgjegjësojë për sfidat që lidhen me aplikimin e metodave kreative dhe zgjidhjeve inovative në arsim. Studentët do të hulumtojnë dhe praktikojnë mjete për të integruar në mënyrë krijuese dhe efektive teknologjinë në mësimdhënie dhe të nxënësve. Studentët do të fitojnë aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për të krijuar përvoja të të mësuarit transformues për studentët e tyre të ardhshëm. Gjithashtu, përmes këtij kursi, studentët trajnohen për të aplikuar të mësuarit e bazuar në projekte në zgjidhjen e problemeve në jetën reale duke u angazhuar në aktivitete mësimore të bazuara në grup, të bazuara në probleme dhe në përvojë, në mënyrë që të përmirësojnë kreativitetin dhe inovacionin e tyre. Në fund të këtij kursi, studentët do të kenë krijuar një portofol artefaktesh dhe një paketë mjetesh burimesh për t'i ndihmuar ata të integrojnë teknologjinë në klasat e tyre të ardhshme.

ETIKA DHE INTEGRITETI AKADEMIK

Ky kurs është krijuar për t'i prezantuar studentët me perspektivat kryesore etike mbi integritetin akademik. Gjithashtu, lënda trajton aspekte të etikës profesionale dhe ndikimin e saj tek studentët, duke ofruar kështu një kuptim të gjerë të etikës dhe identitetit profesional, pastaj definojnë nocionet: vlera, parimet etike, morali, si dhe gjeneza e vlerave etike. Kurrikula i prezanton studentët me integritetin akademik i cili bazohet në disa vlera themelore, të cilat përfshijnë ndershmërinë, respektin dhe drejtësinë. Gjatë gjithë kursit do të ofrohen njohuri teorike dhe aftësi praktike për zbatimin e etikës në mësimdhënie dhe gjithashtu në jetën e përditshme. Gjithashtu, do të trajtohen edhe aspekte të tjera, duke filluar nga kodet etike, teoritë mbi integritetin akademik, standardet e

integritetit akademik e të tjera.

METODAT E HULUMTIMIT KUALITATIV

Kursi ka fokus teorik dhe aplikativ. Së pari do të shqyrtohet mënyrat e zbatimit të metodave kualitative në fushën e arsimit. Kursi do të shtjelloj metodologjinë kualitative si qasje interpretative duke u fokusuar në zhvillimin dhe përdorimin e teorisë, mbledhjen dhe analizën e të dhënave. Studentët do të kenë mundësinë të ekspozohen ndaj qasjeve të ndryshme të realizimit të një studimi kualitativ si dhe do të kenë mundësinë e analizës kritike të shembujve të artikujve të ofruar. Në anën tjetër studentët do të kenë zhvillojnë një projekt-propozim në fushën e arsimit duke adresuar të gjitha elementet e një studimi përmes tij nga perspektiva praktike. Në këtë mënyrë ata do të lidhin aspektet teorike dhe praktike të realizimit të një studimi kualitativ.

PRAKTIKA BASHKËKOHORE NË EDUKIMIN INKLUZIV

Kursi ofron njohuri të avansuara nga fusha e edukimit inkluziv. Në këtë lëndë trajtohen tema që kanë të bëjnë me përkufizimet bashkëkohore të inkluzionit, të drejtat e njeriut/fëmijës, filozofinë e edukimit inkluziv, format e inkluzionit në vende evropiane, mundësitë e krijimit të një shkolle dhe shoqërie inkluzive, etj.. Kursi ofron mundësi të debatimit të problemeve, të sfidave të inkluzionit në vende të ndryshme të botës duke i ndërlidhur me kontekstin kosovar. Ofrohen edhe mundësi të vlerësimit të situatës në institucionet arsimore dhe me gjërë në Kosovë dhe formave të implementimit të edukimit inkluziv.

PSIKOLOGJI E ZBATUAR NË MËSIMDHËNIE

Ky kurs, përmes përmajtjes dhe tematikave specifike u mundëson studentëve të eksplorojnë kornizat teorike të psikologjisë së edukimit si dhe zbatimin e parimeve të këtyre teorive në kontekst të mësimdhënies në klasë. Përmbajtja nga ky kurs paraqet interes për të gjithë ata që janë të përfshirë në mësimdhënie dhe edukim, duke vënë theksin tek rezultatet edukative dhe zbatimi në praktikë i studimeve rreth zhvillimit të fëmijës, shkencës kognitive, mësimdhënies, të nxënit, motivimit e vlerësimit.

VLERËSIMI NË ARSIM

Ky kurs është dizajnuar për t'u ofruar studentëve një kuptim gjithëpërfshirës të teorive, metodave dhe praktikave që lidhen me vlerësimin në arsim. Studentët do të eksplorojnë llojet e ndryshme të vlerësimit, duke përfshirë vlerësimet formative, përmbledhëse dhe diagnostike, ndërsa fitojnë njohuri në hartimin dhe zhvillimin e vlerësimeve efektive në përputhje me rezultatet e të nxënit. Kursi mbulon konceptet kryesore si vlefshmëria dhe besueshmëria, konsideratat etike në vlerësim dhe integrimi i teknologjisë për qëllime vlerësimi. Studentët gjithashtu thellohen në analizën e të dhënave, interpretimin dhe përdorimin e rezultateve të vlerësimit për të planifikuar mësimdhënie efektive. Në përgjithësi, kursi i pajis studentët me njohuri dhe aftësi për të vlerësuar në mënyrë kritike, hartuar dhe zbatuar vlerësimet në mjediset arsimore, të niveleve të ndryshme duke nxitur vendimmarrjen e bazuar në dëshmi dhe përmirësimin në proceset e mësimdhënies dhe të të nxënit. Pjesë e rëndësishme e këtij kursi janë edhe vlerësimet ndërkombëtare dhe vlerësimi I programeve arsimore për qëllime hulumtimi.

HISTORI E ARSIMIT KOMBËTAR

Kursi shtjellon trajektoren e zhvillimit historik të arsimit dhe të mendimit pedagogjik nga lashtësia deri në të kaluarën e afërt të popullit shqiptar. Historia e edukimit kombëtare është dizajnuar që

t'i përfshijë edhe të gjitha ngjarjet historike në fushën e arsimit, ngërthen zhvillimet shoqërore, përpjekjet për shkollë dhe arsimin shqip, ndikimet e shkollave të huaja në trevat shqiptare dhe jashtë tyre në të cilat u arsimuan shumë shqiptarë, zanafilla dhe zhvillimi i institucioneve të para kombëtare edukativo arsimore dhe personalitetet e veçanta kombëtare që lanë gjurmë në historinë e arsimit kombëtar e disa prej tyre edhe në kulturën dhe civilizimin evropian.

ARSIMI NDËRKOMBËTAR DHE KRAHASUES

Ky kurs shërben si hyrje në të kuptuarit e zhvillimeve kryesore në arsimin ndërkombëtar. Ky kurs eksploron konceptet, teoritë dhe çështjet kryesore në fushën e arsimit ndërkombëtar dhe atij krahasues. Studentët do të shqyrtojnë sistemet arsimore në mbarë botën, do të analizojnë faktorët që ndikojnë në rezultatet arsimore dhe do të vlerësojnë në mënyrë kritike politikat dhe praktikat në kontekste të ndryshme kulturore dhe kombëtare. Kursi do të ekspozojë studentët ndaj sistemeve të mira të arsimit nëpër botë dhe shembujve të kontinenteve të ndryshme me fokus të qartë në lidhjet mes kulturës dhe arsimit (përfshirë mostra të modeleve të edukimit si aziatike, skandinave, të Evropës Perëndimore dhe anglo-saksone). Kursi do të ekspozojë studentët ndaj tendencave më të rëndësishme në fushën e arsimit ndërkombëtar. Rezultatet e vlerësimeve ndërkombëtare të tilla si PISA, TIMMS, PIRLS do të diskutohen në bazë të implikimeve që këto kanë në zhvillimin e arsimit. Përveç kësaj, moduli do të shqyrtojë tendencat dhe analizat e akterëve të mëdhenj të arsimit si UNESCO, Banka Botërore, OECD, Komisioni Evropian, dhe aktivitetet e ndryshme të tyre.

STATISTIKË DHE SPSS

Ky kurs është krijuar për t'i njoftuar studentët me konceptet bazë dhe metodat e ndryshme statistikore që aplikohen në kërkimin shkencor pedagogjik. Në këtë kurs, studentët do të njihen me vlerat e ndryshme mesatare duke qenë në gjendje të ndajnë një seri ose shpërndarje në dy pjesë të barabarta, të ndjekura nga masat e shpërndarjes që mundësojnë studimin e duhur të dukurive pedagogjike. Lënda e statistikave u mundëson studentëve të jenë në gjendje të gjejnë pozicionin e rasteve studimore individuale në grup. Në kërkimin pedagogjik përdorim metoda të ndryshme joparametrike që përfshihen në përmbajtjen e lëndës në fjalë, ku studentët do të mund të mësojnë fillimisht dhe të aftësohen për gjetjen e tyre. Ata gjithashtu do të jenë në gjendje të zbulojnë marrëdhëniet midis dukurive pedagogjike përmes korrelacionit, të ndjekur nga analiza shumëvariare, ANOVA, tabela e kryqëzuar dhe duke përfunduar kursin duke përgatitur studentët për të përcaktuar madhësinë e grupeve përfaqësuese.

MËSIMDHËNIA NË ARSIMIN E LARTË

Kursi ofrohet për të analizuar dhe diskutuar aspekte multidimensionale të mësimdhënies në arsimin e lartë. Literatura bashkëkohore syjeron një mësimdhënie interaktive për zhvillim të njohurive, shkathtësive, vlerave, qëndrimeve, bindjeve, me një fjalë për zhvillim të kompetencave të studentëve. Diskutimi orientohet drejt analizës së zhvillimit profesional të mësimdhënësve në arsimin e lartë. Analizohen çështjet e roleve të mësimdhënësit në arsimin e lartë dhe nevojës për zhvillim të njohurive të Përmnajtjes Pedagogjike, Njohuritë e Përmbajtjes Pedagogjike Teknologjike dhe të kompetencave të cilat qojnë drejt zhvillimit të eksperizës së mësimdhënësit në arsimin e lartë.

MËSIMDHËNËSI HULUMTUES

Ky kurs fokusohet në eksplorimin teorik dhe praktik të konceptit mësimdhënës-hulumtues. Me anë të këtij kursi synohet që studentët të njihen me rolin e mësimdhënësve hulumtues, kompetencën

e hulumtimit, planifikimin dhe rëndësinë e kontekstit të hulumtimit, kulturën e hulumtimit, reflektimin, rolin e hulumtimit në zhvillim profesional të mësimeve, dhe ndikimin e hulumtimit në avancimin e bashkëpunimit kolegjial. Gjatë semestrit, studentët do të angazhohen në reflektime teorike nga literatura shkencore dhe profesionale, dhe reflektime praktike përmes hulumtimeve të realizuara në shkollë, duke analizuar format e ndryshme të qenit mësues-hulumtues. Në fund të këtij kursi, studentët do të kuptojnë rëndësinë dhe nevojën e zhvillimit të mësimit-hulumtues si një formë unike e përmirësimit të cilësisë në arsim.

Specializimi: KËSHILLIMI PEDAGOGJIK

Përshkrimet e kurseve

TEORITË E KËSHILLIMIT

Ky kurs eksploron teoritë themelore të këshillimit dhe zbatimin e tyre në një kontekst arsimor. Studentët do të fitojnë një kuptim të kornizave të ndryshme teorike për të rritur aftësinë e tyre për të mbështetur zhvillimin socio-emocional të studentëve, për të adresuar shqetësimet e sjelljes dhe për të nxitur mjedise pozitive të të nxëniet. Kursi përfshin aplikime praktike, raste studimore dhe diskutime të rëndësishme për mjediset pedagogjike. Kursi trajton teoritë më të njohura të këshillimit duke filluar teoritë psikodinamike, humaniste, bihevisoriste, kognitive, etj, që synojnë të shkathtësojnë studentët në të kuptuarit dhe shpjeguarit e sjelljes dhe kognicionit njerëzor. Në secilën javë mësimi trajtohet edhe studime konkrete rasti, që shtjellohen nga vet studentët, duke forcuar kështu tek studentët shkathtësitë reflektive, këshilluese, ndërvepruese dhe praktike për punën direkte me fëmijët/adoleshentët. Kursi trajton edhe sfidat më të shpeshta në punën këshilluese dhe metodat për tejkalimin e këtyre sfidave

SIGURIMI I CILËSISË NË ARSIM

Ky kurs syon të sigurojë aftësitë dhe kompetencat e nevojshme për stafin drejtues, administruar, këshillues dhe mësimdhënës të shkollave, në mënyrë që të sigurojë cilësinë dhe vlerësimin efektiv të arsimit në të gjitha nivelet. Kursi do të ofrojë njohuri për zhvillimet në nivel evropian si dhe për sigurimin e cilësisë dhe metodologjitë e vlerësimit të aplikuara në arsim. Gjithashtu ky kurs synon që të prezantojë konceptin e kulturës së cilësisë dhe planifikimit strategjik afatgjatë dhe t'u ofrojë studentëve mundësi të zhvillimit të aftësive dhe kompetencave të nevojshme për të ndërtuar një kulturë cilësore në shkollë dhe përdorimin e instrumenteve cilësore në ekipet e tyre, për planifikimin strategjik. Kursi gjithashtu merret me identifikimin e nevojave brenda organizatës, përcaktimin e qëllimeve dhe prioriteteve dhe harmonizimin me kulturën e organizatës.

ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSIMDHËNËSVE

Kursi është përgatitur me synimin që studentët e nivelit master të arrijnë të kuptuarit e proceseve të të mësuarit nga ana e mësimdhënësve duke ndërlidhur këtë me kërkesat ndaj mësimdhënësve për profesionalizim të punës së mësimdhënësit. Kursi do të ofrojë pjesëmarrësve një mundësi për në shqyrtim mbi modelet e ndryshme të zhvillimit profesional dhe zgjedhjet që mund të bëjnë menaxherët e shkollave dhe sistemeve të arsimit në funksion të zhvillimit të një mekanizmi të qëndrueshëm të zhvillimit profesional të mësimdhënësve si një mjet për përgatitje profesionale të mësuesve. Kursi ofron mundësi për studentët që të kuptojnë kontekstin e zhvillimit profesional në Kosovë dhe aspektet e organizimit të aktiviteteve të zhvillimit profesional.

MENAXHIMI I PROJEKTEVE

Ky kurs synon që të njoftojë studentët me teorinë dhe praktikën e hartimit dhe zhvillimit të projekteve. Kursi do të ndihmojë studentët të kuptojnë logjikën e të kuptuarit të sistemit arsimor në Kosovë dhe identifikimin e qështjeve që mund të shëndërrohen në projekte zhvillimore në institucione arsimore, ojq, dhe institucione publike me fokus në sistemin arsimor. Edhe pse kursi zbaton logjikën e projekteve të përgjithshme, kjo do të orientohet drejt projekteve zhvillimore në institucione arsimore. Studentët do të kalojnë nëpër hapat dhe procedurat e zhvillimit të një projekti dhe do të kuptojnë edhe aspektet e tjera përcjellëse si monitorimi dhe vlerësimi i projekteve. Më në hollësi, kursi do të adresojë edhe aspektet e planifikimit financiar dhe hartimit

të raporteve të realizimit të projektit.

VËSHITËRËSITË NË TË NXËNË

Kjo lëndë është dizajnuar për të ofruar njohuri teorike dhe shkathtësi praktike lidhur me identifikimin e fëmijëve me vështirësi në të nxënë si dhe për t'u ndihmuar atyre në përmirësimin dhe përjetimin e suksesit përmes zbatimit të metodave efektive të intervenimit. Në këtë mënyrë do të bëhej e mundur përfshirja dhe pjesëmarrja e tyre në procesin mësimor. Edhe pse fëmijët dhe të rinjtë me vështirësi në të nxënë gjenden në çdo klasë, kjo gjendje shpesh neglizhohet në klasat e zakonshme ashtu që nevojat e tyre nuk adresohen fare. Prandaj, identifikimi si dhe trajtimi i fëmijëve me vështirësi në të nxënë do të jenë preokupimet kryesore të kësaj lënde.

PRAKTIKUM I PUNËS SË PEDAGOGUT

Kursi ofron njohuri për punën e pedagogut të shkollës dhe mundësi për zhvillimin e shkathtësive të studentëve lidhur me: planifikimin, programin dhe organizimin e punës arsimore, realizimin e efektshëm të procesit arsimor, përcjelljen, hulumtimin, analizën dhe vlerësimin e punës së shkollës, bashkëpunimin me faktorët në shkollë, zhvillimin profesional të mësimitdhënësve, përkujdesjen për dokumentacionin pedagogjik shkollor, dhe ofrimin e udhëzimeve me qëllim të mbarëvajtjes së sukseshme të procesit arsimor. Për më tepër kursi mundëson promovimin e praktikave të mira për realizimin e efektshëm të detyrave të pedagogut të shkollës.

ZHVILLIMI I KURRIKULAVE

Kursi trajton dimensionet dhe politikat që ndikojnë në formësimin e kurikulës. Kursi poashtu trajton orientimet dhe parimet bazë në hartimin, zbatimin, dhe vlerësimin e kurikulës. Kursi trajton nga perspektiva praktike procesin e hartimit, implementimit dhe vlerësimit të kurrikulave. Studentët do të ndërlidhen me realitetin e procesit kurrikular në Kosovë.

EDUKIMI NË FËMIJËRINË E HERSHME

Lënda "Edukimi në fëmijërinë e hershme " ka për qëllim të përqendrohet në shtjellimin e temave që lidhen me edukimin e fëmijëve në fëmijërinë e hershme, si moshë shumë e rëndësishme për zhvillimin e fëmijëve. Përmbajtja e shkurtër e kësaj lënde përfshin teoritikisht dhe praktikisht temat kryesore të çështjeve që lidhen me edukimin e fëmijëve, pastaj punës që bëhet në institucione parashkollore, lojën, si veprimtari kryesore e fëmijëve të kësaj moshe, dhe promovimin e bashkëpunimit të ndërsjellë ndërmjet institucioneve parashkollore dhe shkollës fillore , në veçanti. Në përgjithësi, lënda Edukimi në fëmijërinë e hershme, përpjeket të sigurojë një kuptim të thellë dhe praktik të rëndësishme që ka puna me fëmijë në fëmijërinë e hershme. Studentët përgatiten për të ndërtuar dhe ruajtur marrëdhënie të suksesshme me prindërit dhe profesionistët tjerë, duke promovuar një mjedis të pasur dhe mbështetës veçanërisht për fëmijët nga lindja deri në moshën 6 vjeçare, po edhe në klasën e parë.

PRAKTIKA PEDAGOGJIKE

Lënda e Praktikës pedagogjike përmbanë njohuri të thelluara mbi vëzhgimin e organizuar për të njohur dhe kuptuar më mirë kontekstin dhe punën në një institucion edukativio-arsimor. Gjithashtu, për të përdorur metoda, teknika e mjete të ndryshme për të regjistruar dhe dokumentuar vëzhgimet dhe për t'i përdorur ato për të reflektuar në mënyrë analitike dhe kritike për proceset e vëzhguara. Studentët do të ushtrojnë të shkruarit reflektiv dhe do të jenë në gjendje të ngrisin debat konstruktiv për përvojat e tyre në IA. Për më tepër, studentët do të përgatiten për

të udhëhequr komunikim dhe këshillim konstruktiv bazuar në përmbajtjet e programit teorik të mëparshëm. Gjatë këtij kursi ata do të ushtrojnë shkathësitë dhe vlerat për qasje konstruktive në praktikën pedagogjike dhe të japin kontributin e tyre maksimal në secilin institucion që marrin pjesë. Do të diskutohet për krijimin e marrëdhënieve kolegjiale dhe etikës së punës në një institucion edukativo-arsimor.

SEMINAR HULUMTIMI

Seminari i hulumtimit ka për qëllim të ofrojë mundësi studentëve që janë në proces të hartimit të projektpropozimeve apo në proces të realizimit të hulumtimit që të avancojnë punën e tyre hulumtuese brenda programit. Seminari ofron mundësi për secilin student që në fillim të definoj një plan të punës për kursin dhe gjatë procesit të angazhohet me kolegë të tjerë në ofrimin dhe marrjen e komenteve kthyesë gjatë hapave kryesor që është duke ndjekur në proces. Roli i ligjëruesit është të menaxhojë procesin, të ofrojë komente kthyesë në punën e studentëve dhe të ofrojë modele të hulumtimeve të ndryshme me qëllim që të ndihmojë studentët në proces. Kursi trajton hapat e planifikimit dhe realizimit të hulumtimit si dhe hartimin e abstrakteve apo edhe raporteve të ndryshme të hulumtimit.

TEZA E MASTERIT

Tema e masterit përmban 20 ECTS dhe paraqet pjesën përfundimtare të Programit Master. Rregullorja e studimeve Master rregullon pikat e përgjithshme të procedurave dhe rregullave të realizimit të punimit përfundimtar – Tezës së masterit. Për shkrimin e temës duhet të zbatohen këto kritere:

- Tema duhet të ketë 15, 000 – 20, 000 fjalë, në fontin 12, Times New Roman.
- Referencat dhe citimi duhet të bëhen sipas standardit të APA-s (American Psychological Association).
- Tema duhet të demonstrojë aftësinë e studentit për të zbatuar metodat dhe teoritë e hulumtimit shkencor në profilin e caktuar.
- Tema duhet të demonstrojë aftësitë e studentit për të reflektuar dhe për të bërë punë hulumtuese në fushën përkatëse.
- Tema duhet të demonstrojë njohuritë, shkathësitë teorike dhe analitike të studentit, për të treguar familjarizimin e tij/saj me terminologjinë, aspektet dhe zhvillimet në fushën përkatëse.
- Temën e punimit e zgjedh vetë studenti në konsultim me personelin akademik të fakultetit, e cila më pas duhet të aprovohet nga Këshilli i Fakultetit përmes departamentit apo kolegjiumit varësisht si përcaktohet me aktet që rregullojnë këtë fushë. Kur student i regjistrohet 13 për të shkruar temën, duhet t'i caktohet edhe afati i përfundimit të saj, ndërsa studentët inkurajohen të nisin diskutimet me personelin akademik për temën para semestrit të tretë.
- Tema e zgjedhur duhet të jetë e ndërlidhur me programin e studimit si dhe relevante për fushat prioritare hulumtuese të Fakultetit dhe për zhvillimin e sistemit shkollor në vend.
- Përmbajtja akademike dhe aftësitë shprehëse të studentit duhet të jenë në harmoni me rregullat e drejtshkrimit.
- Temat e shkruara në gjuhën shqipe duhet të kenë të shkruar përmbledhjen edhe në gjuhën angleze, e nëse tema shkruhet në gjuhën angleze, përmbledhja duhet të jetë e shkruar edhe në gjuhën shqipe.
- Tema duhet të vlerësohet nga komisioni vlerësues më së shumti për dy muaj nga dorëzimi i dorëshkrimit nga kandidati.

Pas vlerësimit, pason prezantimi me gojë i temës, ku fillimisht paraqitet vlerësimi nga komisioni vlerësues dhe pastaj prezantimi nga kandidati. Hollësitë e mëtutjeshme rreth temës së masterit si dhe formati i punimit të temës do të specifikohen në Doracakun përkatës, ndërsa procedurat dhe kriteret shtesë përcaktohen në rregulloren përkatëse të studimeve Master në Fakultetin e Edukimit dhe në rregulloret e tjera në fuqi në Universitetin e Prishtinës.

Specializimi: EDUKIMI INKLUZIV

Përshkrimet e kurseve

ZHVILLIMI ATIPIK

Ky kurs i nivelit master shtjellon specifikat e zhvillimit atipik të fëmijëve, duke eksploruar vonesat zhvillimore, vështirësite neurozhvillimore, psikologjike dhe të sjelljes, si dhe zhillimin e përparuar (dhuntitë, talented). Nëpërmjet një qasjeje multidisiplinare, studentët do të shqyrtojnë faktorë të ndryshëm që kontribuojnë në zhvillimin atipik, duke përfshirë ndikimet gjenetike, mjedisore dhe neurologjike. Studentët do të shqyrtojnë kornizat teorike, kërkimin empirik dhe ndërhyrjet praktike në lidhje me zhvillimin atipik në fusha të tilla si aftësitë njohëse, emocionale, sociale dhe motorike, për të thelluar të kuptuarit dhe shkathtësitë e tyre të zhvillimit atipik gjatë gjithë jetëgjatësisë. Kursi thekson mendimin kritik dhe praktikën e bazuar në dëshmi. Së fundi, kursi fokusohet në nxitjen e empatisë dhe ndjeshmërisë ndaj individëve me zhvillim atipik dhe inkurajon eksplorimin e konsideratave etike në kërkimet shkencore dhe praktikën që lidhet me zhvillimin atipik.

VËSHTIRËSITË NË TË NXËNË

Kjo lëndë është dizajnuar për të ofruar njohuri teorike dhe shkathtësi praktike lidhur me identifikimin e fëmijëve me vështirësi në të nxënë si dhe për t'u ndihmuar atyre në përmirësimin dhe përjetimin e suksesit përmes zbatimit të metodave efektive të intervenimit. Në këtë mënyrë do të bëhej e mundur përfshirja dhe pjesëmarrja e tyre në procesin mësimor. Edhe pse fëmijët dhe të rinjtë me vështirësi në të nxënë gjenden në çdo klasë, kjo gjendje shpesh neglizhohet në klasat e zakonshme ashtu që nevojat e tyre nuk adresohen fare. Prandaj, identifikimi si dhe trajtimi i fëmijëve me vështirësi në të nxënë do të jenë preokupimet kryesore të kësaj lënde.

VËSHTIRËSITË NË TË FOLUR

Kursi ka të bëjë me vështirësitë në të folur si pasojë e çrregullimeve në rrjedhshmërinë e të folurit, të artikulluarit dhe zërit. Kursi gjithashtu elaboron përkritazi me ndikimin e vështirësive në të folur në performancën akademike, psikologjike dhe sociale të fëmijëve/nxënësve. Në këtë kurs përfshihen edhe njohuritë mbi metodat dhe instrumentet e ndryshme që ndërlidhen me vëzhgimin si teknikë për identifikimin e nevojave të fëmijëve/nxënësve me vështirësi në të folur.

LABORATORI PEDAGOGJIK

Laboratori Pedagogjik lidh njohuritë teorike nga programi me aplikimin praktik. Kursi ndihmon në aftësitë për të përfshirë nxënësit me nevoja të veçanta në proceset mësimore, duke promovuar kuptimin e diversitetit dhe kultivimin e mjedisit bashkëpunues. Kursi përfshin fusha psiko-pedagogjike, metodologjike, didaktike, sociologjike-anthropologjike dhe digjitale, duke u përqëndruar në projekte, lojëra dhe vlerësime që e mundësojnë komunikimin efektiv, vlerësimin, planifikimin e arsimit të personalizuar dhe promovimin e arsimit gjithëpërfshirës.

MENAXHIMI I KLASËS INKLUZIVE

Kursi është dizajnuar në mënyrë që studentët të kuptojnë domethënien e klasës inkluzive dhe adresimin e udhëzimeve relevante për një funksionim të efektshëm të klasës inkluzive. Në këtë kurs trajtohen tema që i referohen diversiteteve të nxënësve në klasë, krijimin e klasës në mënyrë që të gjithë nxënësit të ndjehen të mirëseardhur pavarësisht kombit, gjuhës, gjinisë apo

diversiteteve të ndryshme si pasojë e dëmtimeve të natyrave të ndryshme fizike, psikike e emocionale dhe sociale. Gjithashtu, ofrohen edhe modele për zbatim të suksesshëm të praktikave të mira në një klasë inkluzive duke përfshirë edhe menaxhimin e sjelljes dhe të disiplinës në klasë.

MËSIMDHËNIA E DIFERENCUAR DHE PLANI INDIVIDUAL I EDUKIMIT

Njëra ndër sfidat me rëndësi në mësimdhënien e sotme është aftësia për t'u përgjigjur në mënyrë pozitive dhe proaktive ndaj dallimeve ndërmjet nxënësve, pra ndaj diversitetit në klasë. Prandaj, përmes kësaj lënde do të adresohen çështjet e përmendura duke vënë theksin në mësimdhënien e diferencuar ose adaptive dhe në planin, përkatësisht programin e individualizuar për ata nxënës të cilët janë në rrezik për të dështuar në shkollimin e tyre. Mësimdhënia e diferencuar përcaktohet si një punë mësimore e cila përshtatet mbi bazën e karakteristikave dhe nevojave individuale të nxënësve. Të dhënat tregojnë se nëse zbatohet si duhet, mësimdhënia e diferencuar mund të ketë ndikim në përmirësimin e rezultateve të të nxënësve.

SISTEMET MBËSHTETËSE TË EDUKIMIT INKLUZIV

Ky kurs ka të bëjë me analizimin e sistemeve mbështetëse të edukimit inkluziv. Në këtë kurs trajtohen tema që kanë të bëjnë me familjen si sistem mbështetës për fëmijën, përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në sistemin shëndetësorë, edukimin dhe kujdesin në fëmijërinë e hershme, rëndësinë e bashkëpunimit të faktorëve në edukimin e fëmijës, rolin e Qendrave Burimore, mësimdhënësve mbështetës dhe i mësimdhënësve udhëtues për gjithëpërfshirjen e nxënësve me nevoja të veçanta, rolin e shërbimeve pedagogjike, psikologjike dhe logopedike në institucionet edukativo-arsimor.

IDENTIFIKIMI DHE INTERVENIMET E HERSHME

Ky kurs ofron një eksplorim të thellë të teorive, praktikave dhe kërkimeve në lidhje me identifikimin dhe ndërhyrjen e hershme në fusha të ndryshme, duke përfshirë arsimin, psikologjinë, mbrojtjen sociale dhe kujdesin shëndetësor. Studentët familjarizohen me konceptet e cënueshmërisë individuale dhe familjare dhe reziliencës së fëmijëve. Studentët mësojnë për modelet e vlerësimit të zhvillimit që përdoren në fëmijëri të hershme, modelet e intervenimit dhe metodat dhe strategjitë e punës që zbatohen në ambientet e natyrshme të fëmijës. Eksploroohen casjet sistematike dhe familjare, dhe trajtohen raste studimore në çdo orë mësimi. Studentët shkathtësohen të identifikojnë vështirësitë/pengesat në zhvillim, të identifikojnë origjinën e tyre dhe faktorët ndikues, dhe të dizajnojnë/zbatojnë aktivitete bazike intervenuese me fëmijët.

DIVERSITETI DHE DREJTËSIA SOCIALE

Kursi shërben si një hyrje në diversitetin dhe drejtësinë sociale në kontekstin e praktikës arsimore. Kursi synon të rrisë kompetencën kulturore dhe shoqërore duke rritur ndërgjegjësimin e studentëve për vlerat, supozimet dhe paragjykimet e tyre, si dhe për marrëdhëniet dhe stilet e tyre të ndërveprimit dhe komunikimit me fëmijë nga grupet e ndryshme sociale. Kompetenca konsiderohet në dimensionet e vlerave, njohurive, aftësive dhe proceseve njohëse dhe afektive. Kursi synon vetëdijësimin mbi diversitetin që karakterizon dhe formëson përvojën njerëzore dhe formimin e identitetit individual dhe grupor. Lënda i qaset diversitetit nga perspektiva e ndërseksionalitetit, një perspektivë në të cilën dimensionet e diversitetit kuptohen si ndërveprimi i njëkohshëm i faktorëve të shumtë duke përfshirë por pa u kufizuar në statusin socio-ekonomik, kulturën, përkatësinë etnike, kombësinë, ngjyrën, seksin, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, moshën, aftësinë e kufizuar, statusin e marrëdhënies, ideologjinë politike, fejen/spiritualitetin, etj.

PRAKTIKA PEDAGOGJIKE

Lënda e Praktikës pedagogjike përmbanë njohuri të thelluara mbi vëzhgimin e organizuar për të njohur dhe kuptuar më mirë kontekstin dhe punën në një institucion edukativo-arsimor. Gjithashtu, për të përdorur metoda, teknika e mjete të ndryshme për të regjistruar dhe dokumentuar vëzhgimet dhe për t'i përdorur ato për të reflektuar në mënyrë analitike dhe kritike për proceset e vëzhguara. Studentët do të ushtrojnë të shkruarit reflektiv dhe do të jenë në gjendje të ngrisin debat konstruktiv për përvojat e tyre në IA. Për më tepër, studentët do të përgatiten për të udhëhequr komunikim dhe këshillim konstruktiv bazuar në përmbajtjet e programit teorik të mëparshëm. Gjatë këtij kursi ata do të ushtrojnë shkathësitë dhe vlerat për qasje konstruktive në praktikën pedagogjike dhe të japin kontributin e tyre maksimal në secilin institucion që marrin pjesë. Do të diskutohet për krijimin e marrëdhënieve kolegjinale dhe etikës së punës në një institucion edukativo-arsimor.

SEMINAR HULUMTIMI

Seminari i hulumtimit ka për qëllim të ofrojë mundësi studentëve që janë në proces të hartimit të projektpropozimeve apo në proces të realizimit të hulumtimit që të avancojnë punën e tyre hulumtuese brenda programit. Seminari ofron mundësi për secilin student që në fillim të definoj një plan të punës për kursin dhe gjatë procesit të angazhohet me kolegë të tjerë në ofrimin dhe marrjen e komenteve kthyesë gjatë hapave kryesor që është duke ndjekur në proces. Roli i ligjëruesit është të menaxhojë procesin, të ofrojë komente kthyesë në punën e studentëve dhe të ofrojë modele të hulumtimeve të ndryshme me qëllim që të ndihmojë studentët në proces. Kursi trajton hapat e planifikimit dhe realizimit të hulumtimit si dhe hartimin e abstrakteve apo edhe raporteve të ndryshme të hulumtimit.

TEZA E MASTERIT

Tema e masterit përmban 20 ECTS dhe paraqet pjesën përfundimtare të Programit Master. Rregullorja e studimeve Master rregullon pikat e përgjithshme të procedurave dhe rregullave të realizimit të punimit përfundimtar – Tezës së masterit. Për shkrimin e temës duhet të zbatohen këto kritere:

- Tema duhet të ketë 15, 000 – 20, 000 fjalë, në fontin 12, Times New Roman.
- Referencat dhe citimi duhet të bëhen sipas standardit të APA-s (American Psychological Association).
- Tema duhet të demonstrojë aftësinë e studentit për të zbatuar metodat dhe teoritë e hulumtimit shkencor në profilin e caktuar.
- Tema duhet të demonstrojë aftësitë e studentit për të reflektuar dhe për të bërë punë hulumtuese në fushën përkatëse.
- Tema duhet të demonstrojë njohuritë, shkathësitë teorike dhe analitike të studentit, për të treguar familjarizimin e tij/saj me terminologjinë, aspektet dhe zhvillimet në fushën përkatëse.
- Temën e punimit e zgjedh vetë studenti në konsultim me personelin akademik të fakultetit, e cila më pas duhet të aprovohet nga Këshilli i Fakultetit përmes departamentit apo kolegjiut varësisht si përcaktohet me aktet që rregullojnë këtë fushë. Kur studentit regjistrohet 13 për të shkruar temën, duhet t'i caktohet edhe afati i përfundimit të saj, ndërsa studentët inkurajohen të nisin diskutimet me personelin akademik për temën para semestrit të tretë.
- Tema e zgjedhur duhet të jetë e ndërlidhur me programin e studimit si dhe relevante për fushat prioritare hulumtuese të Fakultetit dhe për zhvillimin e sistemit shkollor në vend.

- Përbajtja akademike dhe aftësitë shprehëse të studentit duhet të jenë në harmoni me rregullat e drejtshkrimit.
- Temat e shkruara në gjuhën shqipe duhet të kenë të shkruar përmbledhjen edhe në gjuhën angleze, e nëse tema shkruhet në gjuhën angleze, përmbledhja duhet të jetë e shkruar edhe në gjuhën shqipe.
- Tema duhet të vlerësohet nga komisioni vlerësues më së shumti për dy muaj nga dorëzimi i dorëshkrimit nga kandidati.

Pas vlerësimit, pason prezantimi me gojë i temës, ku fillimisht paraqitet vlerësimi nga komisioni vlerësues dhe pastaj prezantimi nga kandidati. Hollësitë e mëtutjeshme rreth temës së masterit si dhe formati i punimit të temës do të specifikohen në Doracakun përkatës, ndërsa procedurat dhe kriteret shtesë përcaktohen në rregulloren përkatëse të studimeve Master në Fakultetin e Edukimit dhe në rregulloret e tjera në fuqi në Universitetin e Prishtinës.

Specializimi: UDHËHEQJA NË ARSIM

Përshkrimet e kurseve

NDRYSHIMET NË ARSIM

Ky kurs ka për synim që studentët të njihen me konceptet dhe proceset e ndryshimeve në arsim. Secili sistem i arsimit është në baza të rregullta i përfshirë në procesin e ndryshimeve dhe në këtë kontekst ndryshimet në arsim shihen si proces dhe jo një pikë e caktuar e synuar. Në anën tjetër secili punonjës i arsimit ndërlidhet me ndryshimet në arsim dhe ka një rol dhe përgjegjësi në zhvillimin e cilësisë së arsimit varësisht nga konteksti dhe rrethanat në të cilat funksionon ai/ajo. Të kuptuarit e ndryshimit në arsim është një proces mjaft kompleks dhe mënyra si ne si individë sillemi, mënyra si menaxhohet institucioni shkollor dhe mënyra si planifikohet dhe menaxhohet sistemi i arsimit janë esenciale por edhe koherenca midis këtyre niveleve është thelbësore për menaxhimin e ndryshimeve drejt gjendjes së dëshiruar.

MENAXHIMI I INSTITUCIONEVE ARSIMORE

Me anë të këtij kursi synohet që studentët të njihen me metoda bashkëkohore të menaxhimit të institucioneve arsimore dhe t'i shfrytëzojnë ato në kontesktin e punës së tyre. Temat që do të mbulohen në këtë kurs janë: konceptet e menaxhimit në arsim, debatet në mes të administrimit dhe menaxhimi në arsim, motivimi, dinamika e grupit dhe ndërtimi i ekepeve, delegimi, komunikimi dhe bashkëpunimi me akterë kryesor, menaxhimi i personelit, planifikimi i nevojave të ardhshme për personelin e institucionit arsimor, etj. Meqë menaxhimi bashkëkohor realizohet në bashkëpunim me akterë të tjerë, puna e studentëve gjatë këtij kursi organizohet në grupe, ashtu që krahas njohurive për udhëheqje të institucioneve arsimore, të fitohen edhe shprehje të komunikimit, raportimit, dhe të bashkëpunimit me të tjerët.

TEORITË DHE STILET E MENAXHIMIT

Në këtë kurs do të shqyrtohen teoritë dhe praktikat moderne të menaxhimit dhe udhëheqjes në arsim. Temat që do të mbulohen në këtë kurs janë: Teoritë menaxhimit dhe stilet e udhëheqjes, roli i udhëheqjes (sfidat dhe perspektivat), karakteristikat e udhëheqësve efektivë, praktikat innovative, etj. Çështjet tjera që trajton ky kurs kanë të bëjnë me të kuptuarit e rolit të udhëheqësit për krijimin e kushteve dhe mjedisit të përshtatshëm për ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies, si dhe zhvillimit organizativ.

PLANIFIKIMI NË ARSIM

Ky kurs synon që studentët të njihen me metoda bashkëkohore të planifikimit në arsim dhe t'i shfrytëzojnë ato në tranformimin e shkollës dhe institucioneve të tjera arsimore. Fokus kryesor i kursit do të jetë planifikimi zhvillimor i shkollës si mekanizëm për përmirësim të institucioneve arsimore. Meqë planifikimi bashkëkohor realizohet në bashkëpunim, puna e studentëve gjatë këtij kursi organizohet në grupe, ashtu që krahas njohurive për planifikim të fitohen edhe shprehje të komunikimit dhe të bashkëpunimit me të tjerët. Mekanizmat e planifikimit në arsim, që adresohen gjatë realizimit të këtij kursi, mund të shfrytëzohen në mjedise arsimore, por edhe në mjedise të tjera me karakter jobiznesor.

MENAXHIMI I PROJEKTEVE

Ky kurs synon që të njoftojë studentët me teorinë dhe praktikën e hartimit dhe zhvillimit të projekteve. Kursi do të ndihmojë studentët të kuptojnë logjikën e të kuptuarit të sistemit arsimor në Kosovë dhe identifikimin e qështjeve që mund të shëndërrohen në projekte zhvillimore në institucione arsimore, ojç, dhe institucione publike me fokus në sistemin arsimor. Edhe pse kursi zbaton logjikën e projekteve të përgjithshme, kjo do të orientohet drejt projekteve zhvillimore në institucione arsimore. Studentët do të kalojnë nëpër hapat dhe procedurat e zhvillimit të një projekti dhe do të kuptojnë edhe aspektet e tjera përcjellëse si monitorimi dhe vlerësimi i projekteve. Më në hollësi, kursi do të adresojë edhe aspektet e planifikimit financiar dhe hartimit të raporteve të realizimit të projektit.

KULTURA ORGANIZATIVE

Ky kurs ka për qëllim që të eksploroj në mënyrë të thelluar konceptet kyçe të kulturës organizative dhe marrëdhënien komplekse në mes të kulturës organizative, udhëheqjes, dhe rezultateve arsimore brenda insitucioneve arsimore. Gjatë kursit studentët do të njoftohen me ndikimin e kulturës orgnaizative në udhëheqje, sjellje sociale dhe zhvillim organizativ dhe do të shqyrtojnë korniza teorike të kulturës organizative, tipologjitë, dhe strategjitë për vlerësimin dhe menaxhimin e kulturës brenda shkollave, duke nxitur udhëheqjen efektive dhe zhvillimin e shkollës brenda mjediseve të ndryshme dhe diverse arsimore.

SIGURIMI I CILËSISË NË ARSIM

Ky kurs syon të sigurojë aftësitë dhe kompetencat e nevojshme për stafin drejtues, administrues, këshillues dhe mësime dhënëse të shkollave, në mënyrë që të sigurojë cilësinë dhe vlerësimin efektiv të arsimit në të gjitha nivelet. Kursi do të ofrojë njohuri për zhvillimet në nivel evropian si dhe për sigurimin e cilësisë dhe metodologjitë e vlerësimit të aplikuara në arsim. Gjithashtu ky kurs synon që të prezantojë konceptin e kulturës së cilësisë dhe planifikimit strategjik afatgjatë dhe t'u ofrojë studnetëve mundësi të zhvillimit të aftësive dhe kompetencave të nevojshme për të ndërtuar një kulturë cilësore në shkollë dhe përdorimin e instrumenteve cilësore në ekipet e tyre, për planifikimin strategjik. Kursi gjithashtu merret me identifikimin e nevojave brenda organizatës, përcaktimin e qëllimeve dhe prioriteteve dhe harmonizimin me kulturën e organizatës.

ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSIMDHËNËSVE

Kursi është përgatitur me synimin që studentët e nivelit master të arrijnë të kuptuarit e proceseve të të mësuarit nga ana e mësime dhënëse duke ndërlidhur këtë me kërkesat ndaj mësime dhënëse për profesionalizim të punës së mësime dhënëse. Kursi do ti ofrojë pjesëmarrësve një mundësi për në shqyrtim mbi modelet e ndryshme të zhvillimit profesional dhe zgjedhjet që mund të bëjnë menaxherët e shkollave dhe sistemeve të arsimit në funksion të zhvillimit të një mekanizmi të qëndrueshëm të zhvillimit profesional të mësime dhënëseve si një mjet për përgaditje profesionale të mësuesve. Kursi ofron mundësi për studentët që të kuptojnë kontekstin e zhvillimit profesional në Kosovë dhe aspektet e organizimit të aktiviteteve të zhvillimit profesional.

PRAKTIKA PEDAGOGJIKE

Ky kurs synon të pajisë udhëheqësit aspirantë arsimorë me aftësitë, njohuritë dhe përvojën praktike thelbësore të nevojshme për të udhëhequr dhe menaxhuar në mënyrë efektive shkollat. Ky kurs krijon një hapsirë për zbatimin praktik të teorive të lidhshme dhe praktikave më të mira brenda kontekstit dinamik të insitucioneve arsimore. Pjesëmarrësit do të angazhohen në një eksplorim gjithëpërfshirës të elementeve kyçe të udhëheqjes arsimore, duke përfshirë planifikimin strategjik,

udhëheqjen udhëzuese, menaxhimin organizativ dhe angazhimin e komunitetit.

SEMINAR HULUMTIMI

Seminari i hulumtimit ka për qëllim të ofrojë mundësi studentëve që janë në proces të hartimit të projektpropozimeve apo në proces të realizimit të hulumtimit që të avancojnë punën e tyre hulumtuese brenda programit. Seminari ofron mundësi për secilin student që në fillim të definojë një plan të punës për kursin dhe gjatë procesit të angazhohet me kolegë të tjerë në ofrimin dhe marrjen e komenteve kthyesë gjatë hapave kryesor që është duke ndjekur në proces. Roli i ligjëruesit është të menaxhojë procesin, të ofrojë komente kthyesë në punën e studentëve dhe të ofrojë modele të hulumtimeve të ndryshme me qëllim që të ndihmojë studentët në proces. Kursi trajton hapat e planifikimit dhe realizimit të hulumtimit si dhe hartimin e abstrakteve apo edhe raporteve të ndryshme të hulumtimit.

TEZA E MASTERIT

Tema e masterit përmban 20 ECTS dhe paraqet pjesën përfundimtare të Programit Master. Rregullorja e studimeve Master rregullon pikat e përgjithshme të procedurave dhe rregullave të realizimit të punimit përfundimtar – Tezës së masterit. Për shkrimin e temës duhet të zbatohen këto kritere:

- Tema duhet të ketë 15, 000 – 20, 000 fjalë, në fontin 12, Times New Roman.
- Referencat dhe citimi duhet të bëhen sipas standardit të APA-s (American Psychological Association).
- Tema duhet të demonstrojë aftësinë e studentit për të zbatuar metodat dhe teoritë e hulumtimit shkencor në profilin e caktuar.
- Tema duhet të demonstrojë aftësitë e studentit për të reflektuar dhe për të bërë punë hulumtuese në fushën përkatëse.
- Tema duhet të demonstrojë njohuritë, shkathësitë teorike dhe analitike të studentit, për të treguar familjarizimin e tij/saj me terminologjinë, aspektet dhe zhvillimet në fushën përkatëse.
- Temën e punimit e zgjedh vetë studenti në konsultim me personelin akademik të fakultetit, e cila më pas duhet të aprovohet nga Këshilli i Fakultetit përmes departamentit apo kolegjiut varësisht si përcaktohet me aktet që rregullojnë këtë fushë. Kur studenti regjistrohet 13 për të shkruar temën, duhet t'i caktohet edhe afati i përfundimit të saj, ndërsa studentët inkurajohen të nisin diskutimet me personelin akademik për temën para semestrit të tretë.
- Tema e zgjedhur duhet të jetë e ndërlidhur me programin e studimit si dhe relevante për fushat prioritare hulumtuese të Fakultetit dhe për zhvillimin e sistemit shkollor në vend.
- Përmbajtja akademike dhe aftësitë shprehëse të studentit duhet të jenë në harmoni me rregullat e drejtshkrimit.
- Temat e shkruara në gjuhën shqipe duhet të kenë të shkruar përmbledhjen edhe në gjuhën angleze, e nëse tema shkruhet në gjuhën angleze, përmbledhja duhet të jetë e shkruar edhe në gjuhën shqipe.
- Tema duhet të vlerësohet nga komisioni vlerësues më së shumti për dy muaj nga dorëzimi i dorëshkrimit nga kandidati.

Pas vlerësimit, pason prezantimi me gojë i temës, ku fillimisht paraqitet vlerësimi nga komisioni vlerësues dhe pastaj prezantimi nga kandidati. Hollësitë e mëtutjeshme rreth temës së masterit si dhe formati i punimit të temës do të specifikohen në Doracakun përkatës, ndërsa procedurat dhe kriteret shtesë përcaktohen në rregulloren përkatëse të studimeve Master në Fakultetin e Edukimit dhe në rregulloret e tjera në fuqi në Universitetin e Prishtinës.

Specializimi: MËSIMDHËNIA DHE KURRIKULA

Përshkrimet e kurseve

TEORITË KURRIKULARE

Ky kurs i avancuar synon t'u mundësojë studentëve të hulumtojnë në gjerësisht teoritë kurrikulare, duke nxitur një kuptim më të thellë të parimeve themelore dhe perspektivave bashkëkohore që formojnë në mënyrë të ndërlikuar zhvillimin e kurrikulës. Nëpërmjet ekzaminimit gjithëpërfshirës të teorive të ndryshme, studentët do të kultivojnë ekspertizën e nevojshme për të hartuar kurrikula inovative, me fëmijët në qendër, të përshtatura për kontekste të ndryshme arsimore. Studentët do të inkurajohen për të marrë pjesë aktive në diskutime kritike, për të analizuar studimet e rasteve dhe për të aplikuar korniza teorike për skenarët real. Studentët do të përgatiten dhe të fuqizohen për të marrë role udhëheqëse, duke nxitur inovacionin në fusha në zhvillim e edukimit, në çdo kohë.

MODELET E MËSIMDHËNIES NDËRVEPRUESE

Modelet e mësimdhënies ndërvepruese, është një kurs që fokusohet në mënyrë tipike në metodat, qasjet dhe filozofitë inovative dhe efektive të mësimdhënies të përshtatura për mësimdhënsit që punojnë në mjediset e ndryshme arsimore. Përmbajtja e kursit përfshin koncepte të zhvillimit të mësimdhënies bazuar në stile të ndryshme të të nxënit duke prekur strategji të llojlloshme që përbushin nevojat e secilit individ dhe kështu duke siguruar gjithëpërfshirje, të nxënë aktiv, motivim për të nxënë, zhvillim të shkathtësive të buta dhe të mendimit kritik e kreativ. Qëllimi kryesor i këtij kursi është që tek mësimdhënsit e ardhshëm të zhvillohen shkathtësitë e zbatimit të strategjive të ndryshme bashkëkohore të mësimdhënies dhe të nxënit ndërveprues. Poashtu ky kurs synon që tek studentët të zhvillojë aftësitë analitike të ndërlidhjes midis qëllimit të edukimit dhe metodave të mësimdhënies dhe vlerësimit.

INTELEJENCA ARTIFICIALE NË EDUKIM

Kursi synon që të zhvillojë në mënyrë teorike dhe praktike njohuritë lidhur me konceptet dhe zhvillimet e fundit të teknologjisë së Inteligjencës Artificiale (IA) dhe trendëve të Gjeneruesve IA për mbështetjen e proceseve të mësimdhënies dhe mesimnxenies, inkluzionit, automatizimit të aktivitetëve administrative, dhe menaxhimit të procesit mësimor. Kursi fokusohet në aftësimin teorik dhe praktik të studentëve për të shfrytëzuar Gjeneruesit AI, Chatbot-at si asistent personal për të facilituar dhe personalizuar procesin mësimor, dhe ofruar njohuri mbi veglat, simulatoret që studentet mund të përdorin për të krijuar materiale mësimore dhe vlerësuese duke vendosur me theks të vecant të menduarit kritik, kreativitetin, inovacionin, monitorimin dhe aktivitetet mësimore në një perspektivë gjithëpërfshirëse.

DIVERSITETI NË ARSIM

Kursi egzaminon diversitetin në kontekstin e praktikës arsimore, dhe fokusohet në kultivimin e kompetencës kulturore dhe shoqërore duke rritur ndërgjegjësimin e studentëve për vlerat, supozimet dhe paragjykimet e tyre, si dhe për marrëdhëniet dhe stilet e tyre të ndërveprimit dhe komunikimit me fëmijë nga grupet e ndryshme sociale. Kompetenca konsiderohet në dimensionet e vlerave, njohurive, aftësive dhe proceseve njohëse dhe afektive. Kursi synon vetëdijësimin mbi diversitetin që karakterizon dhe formëson përvojën njerëzore dhe formimin e identitetit individual dhe grupor.

EDUKIMI NË FËMIJËRINË E HERSHME

Lënda "Edukimi në fëmijërinë e hershme " ka për qëllim të përqendrohet në shtjellimin e temave

që lidhen me edukimin e fëmijëve në fëmijërinë e hershme, si moshë shumë e rëndësishme për zhvillimin e fëmijëve. Përmbajtja e shkurtër e kësaj lënde përfshin teoritikisht dhe praktikisht temat kryesore të çështjeve që lidhen me edukimin e fëmijëve, pastaj punës që bëhet në institucione parashkollore, lojën, si veprimtari kryesore e fëmijëve të kësaj moshe, dhe promovimin e bashkëpunimit të ndërsjellë ndërmjet institucioneve parashkollore dhe shkollës fillore, në veçanti. Në përgjithësi, lënda Edukimi në fëmijërinë e hershme, përpjeket të sigurojë një kuptim të thellë dhe praktik të rëndësishme që ka puna me fëmijë në fëmijërinë e hershme. Studentët përgatiten për të ndërtuar dhe ruajtur marrëdhënie të suksesshme me prindërit dhe profesionistët tjerë, duke promovuar një mjedis të pasur dhe mbështetës veçanërisht për fëmijët nga lindja deri në moshën 6 vjeçare, po edhe në klasën e parë.

PLANIFIKIMI NË ARSIM

Ky kurs synon që studentët të njihen me metoda bashkëkohore të planifikimit në arsim dhe t'i shfrytëzojnë ato në transformimin e shkollës dhe institucioneve të tjera arsimore. Fokus kryesor i kursit do të jetë planifikimi zhvillimor i shkollës si mekanizëm për përmirësim të institucioneve arsimore. Meqë planifikimi bashkëkohor realizohet në bashkëpunim, puna e studentëve gjatë këtij kursi organizohet në grupe, ashtu që krahas njohurive për planifikim të fitohen edhe shprehje të komunikimit dhe të bashkëpunimit me të tjerët. Mekanizmat e planifikimit në arsim, që adresohen gjatë realizimit të këtij kursi, mund të shfrytëzohen në mjedise arsimore, por edhe në mjedise të tjera me karakter jobiznesor.

KURS I AVANSUAR NË MENAXHIMIN E KLASËS

Kursi është dizajnuar në mënyrë që studentët të kuptojnë rëndësinë dhe rolin që kanë mësimitdhënësit në menaxhimin e klasës. Kursi ka për qëllim që të eksplorojë në mënyrë të thelluar konceptet kyçe të menaxhimit të klasës. Trajtohen tema që i referohen teorive dhe praktikave për menaxhimin e klasës. Studentët gjatë kursit njoftohen me fazat, faktorët, mjedisin fizik, didaktik të klasës, qasjet dhe strategjitë për menaxhim efektiv.

PRAKTIKA PEDAGOGJIKE

Ky kurs ka për qëllim praktikimin e njohurive dhe shkathtësive të përfituara nga kurset e tjera në ambient real në ndonjë institucion arsimor. Studentët do të qëndrojnë në institucione arsimore për katër javë rradhazi, çdo ditë pune në orar të plotë ndërsa një herë në javë do të takohen në fakultet për të shkëmbyer përvojat dhe për të reflektuar praktikën që kanë vëzhguar ose zbatuar. Vëzhgimi dhe pjesëmarrja aktive e studentëve në jetën shkollore është e domosdoshme për të zhvilluar shkathtësitë në një ambient autentik. Studentët do të përdorin ditarin reflektiv personal duke dokumentuar çdo ditë të praktikës në IA. Studentët do të analizojnë dokumentacionin pedagogjik, planet mësimore të përgatitura nga mësimitdhënësit, do të japin komente mbi ato plane dhe të gjitha do t'i organizojnë në portfolio. Do të mbajnë takime me nxënësit duke synuar njohjen e nevojave, vështirësive, interesave që mund të kenë. Gjithashtu, ata mund të mbajnë edhe takime individuale me nxënësit dhe prindërit me qëllim të ofrimit të përkrahjes së nxënësve në të nxënë. Studentët duhet të marrin pjesë në çdo aktivitet që organizohet në shkollë, mledhje të prindërve, aktivitete kulturore apo me aktivitete për zhvillim të vazhdueshëm profesional.

SEMINAR HULUMTIMI

Seminari i hulumtimit ka për qëllim të ofrojë mundësi studentëve që janë në proces të hartimit të projektpropozimeve apo në proces të realizimit të hulumtimit që të avancojnë punën e tyre hulumtuese brenda programit. Seminari ofron mundësi për secilin student që në fillim të definoj

një plan të punës për kursin dhe gjatë procesit të angazhohet me kolegë të tjerë në ofrimin dhe marrjen e komenteve kthyesë gjatë hapave kryesor që është duke ndjekur në proces. Roli i ligjëruesit është të menaxhojë procesin, të ofrojë komente kthyesë në punën e studentëve dhe të ofrojë modele të hulumtimeve të ndryshme me qëllim që të ndihmojë studentët në proces. Kursi trajton hapat e planifikimit dhe realizimit të hulumtimit si dhe hartimin e abstrakteve apo edhe raporteve të ndryshme të hulumtimit.

TEZA E MASTERIT

Tema e masterit përmban 20 ECTS dhe paraqet pjesën përfundimtare të Programit Master. Rregullorja e studimeve Master rregullon pikat e përgjithshme të procedurave dhe rregullave të realizimit të punimit përfundimtar – Tezës së masterit. Për shkrimin e temës duhet të zbatohen këto kritere:

- Tema duhet të ketë 15, 000 – 20, 000 fjalë, në fontin 12, Times New Roman.
- Referencat dhe citimi duhet të bëhen sipas standardit të APA-s (American Psychological Association).
- Tema duhet të demonstrojë aftësinë e studentit për të zbatuar metodat dhe teoritë e hulumtimit shkencor në profilin e caktuar.
- Tema duhet të demonstrojë aftësitë e studentit për të reflektuar dhe për të bërë punë hulumtuese në fushën përkatëse.
- Tema duhet të demonstrojë njohuritë, shkathtësitë teorike dhe analitike të studentit, për të treguar familjarizimin e tij/saj me terminologjinë, aspektet dhe zhvillimet në fushën përkatëse.
- Temën e punimit e zgjedh vetë studenti në konsultim me personelin akademik të fakultetit, e cila më pas duhet të aprovohet nga Këshilli i Fakultetit përmes departamentit apo kolegjiut varësisht si përcaktohet me aktet që rregullojnë këtë fushë. Kur studenti regjistrohet 13 për të shkruar temën, duhet t'i caktohet edhe afati i përfundimit të saj, ndërsa studentët inkurajohen të nisin diskutimet me personelin akademik për temën para semestrit të tretë.
- Tema e zgjedhur duhet të jetë e ndërlidhur me programin e studimit si dhe relevante për fushat prioritare hulumtuese të Fakultetit dhe për zhvillimin e sistemit shkollor në vend.
- Përmbajtja akademike dhe aftësitë shprehëse të studentit duhet të jenë në harmoni me rregullat e drejtshkrimit.
- Temat e shkruara në gjuhën shqipe duhet të kenë të shkruar përmbledhjen edhe në gjuhën angleze, e nëse tema shkruhet në gjuhën angleze, përmbledhja duhet të jetë e shkruar edhe në gjuhën shqipe.
- Tema duhet të vlerësohet nga komisioni vlerësues më së shumti për dy muaj nga dorëzimi i dorëshkrimit nga kandidati.

Pas vlerësimit, pason prezantimi me gojë i temës, ku fillimisht paraqitet vlerësimi nga komisioni vlerësues dhe pastaj prezantimi nga kandidati. Hollësitë e mëtutjeshme rreth temës së masterit si dhe formati i punimit të temës do të specifikohen në Doracakun përkatës, ndërsa procedurat dhe kriteret shtesë përcaktohen në rregulloren përkatëse të studimeve Master në Fakultetin e Edukimit dhe në rregulloret e tjera në fuqi në Universitetin e Prishtinës.